

RELACION PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.01.1995 “KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR”

Projektligji “Për disa ndryshime ne Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë” ka si qëllim të përmirësojë Kodin Penal në fuqi në dy drejtime: *së pari* të paraqesë një dispozitë të re përjashtuese nga përgjegjësia penale në disa kushte të mirëpërcaktuara për autorin e veprës penale në fushën e zgjedhjeve, dhe *së dyti* të rregullojë disa parregullsi të evidentuara në shkrimin e disa dispozitave të këtij kreu.

Duke pasur si qëllim luftën sa më efektive ndaj krimeve dhe veprave të tjera penale në fushën e zgjedhjeve, por me theks të veçantë shitblerjen e votës, dhe duke qënë se kjo është një figurë veprë penale që kryhet nga persona që i përkasin shtresave më në nevojë dhe më të varfra të shoqërisë, propozohet që ata që kryejne vepra penale të parashikuara në kreun e veprave penale kundër zgjedhjeve të lira dhe demokratike dhe që bashkëpunojnë dhe ndihmojnë organet e ndjekjes penale për hetimin, si dhe për zbulimin e personave të tjerë, bashkëpunëtorë në kryerjen e veprës penale ose autorë të veprave të tjera të lidhura, do të përjashtohen nga dënimi për veprën penale të kryer prej tij.

Në nenin 328, në paragrafin e fundit të nenit 328/a dhe në nenin 328/b propozohet të shfuqizohen fjalët “në kundërshtim me ligjin”. Veprimet që parashikojnë këto dispozita penale janë përherë në kundërshtim me ligjin, ndaj edhe për pasojë duhet të shfuqizohet ky togfjalësh.